



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS – KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më ___/___/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Hipoklorite dhe klorate 24312200-6

Hipoklorit Natriumi 24312220-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

10,350,000 (dhjetë milion e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizime Fier”Sh.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

➤ **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

➤ **2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

➤ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

• 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2019-2020-2021), **ku vlera mesatare e së cilës, të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e kontratës (vlera e fondit limit).** Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori Ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në *nenin 77 pika 3 i LPP*, si dhe *nenin 43 pika 2, gërma "b" të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*.

Përcaktimi i vlerës dhe i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, argumentohet si vijon: Vendosija e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilanceve për vitet (2020-2021) të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në *nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"* dhe i shërben AK që të vërtetojë se OE fitues disponon të gjithë kapacitetin e duhur financiar për të realizuar kontratën.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në *nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "*Per procedurat tatimore*" i ndryshuar, nëni 3.1/a, b, c dhe nëni 40, në ligjin nr.131/2015 "*Per QKB*" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "*Per QKR*" i ndryshuar.

2.3 Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", **Neni 83:**

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës. **Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është: 207.000 (dyqind e shtatë mijë) lekë pa TVSH.**

Kapaciteti ekonomik i "Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Fier" Sh.a, është i qëndrueshëm dhe e përballon fondin limit për këtë prokurim dhe kontratën që do të lidhet pas përfundimit.

Sqarim:

Në zbatim të Ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, si dhe të njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe APP, respektivisht me nr. 25366 prot dhe nr.8480 prot, datë 30.12.2020, njoftojmë operatorët ekonomikë pjesmarrës që për nënshkrimin e kontratës publike, në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.
- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Çertifikuar për zgjidhjen softëare-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike".

➤ 2.3 KAPACITETI TEKNIK DHE PROFESIONAL:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2020-2021-2022) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera totale e të cilave duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet**, të realizuar gjatë ketyre tre viteve.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1/gërma "c" të Ligjit nr.162, dt.23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Cilësisë **ISO 9001:2015** ose (*ekuivalente/ e barazvlefshme me të*) lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes.)

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas nenit 79 pika 1, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe në nenin 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit. Çertifikatat duhet të lëshohen nga organet kompetente për të vërtetuar se mallrat i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duke mundur realizimin në kohë dhe me cilësi sipas standarteve të kërkuara.

2.3.3 Ofertuesi duhet të vërtetojë që Hipokloriti i Natriumit që do të furnizohet është i përshtatshëm në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, konform normave europiane **EN 901:2013** ose "ekuivalente".

Për këtë qëllim duhet të paraqitet si dokument kualifikues, dokumentacion nga prodhuesi, që dëshmon që produkti i prodhuar plotëson standartin e kërkuar EN 901:2013. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rast se OE nuk është prodhues, pranohet dhe një vetdeklarim nga OE ofertues që në këtë rast furnizuesi është konform standarteve (*duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij*).

Arsyetimi: Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE duhet të paraqesin dëshmi që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale për të krijuar bindjen se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara. Është në të drejten e AK të kërkojë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, bazuar në **pikën 6/c, të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021** “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.4 Ofertuesi duhet të paraqesi çertifikatën e analizës nga **Instituti i Shëndetit Publik**, ose dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuara për lëshimin e tyre, për analizë toksikologjike për NaOCl. (hipoklorit natriumi) të marrë **brenda 3 muajve** të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Arsyetimi: Kriteret e kualifikimit vendosen që ti shërbejnë AK-së, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme si aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe çdo element tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 40 pika 6/”c”.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me **Çertifikatën ISO 14001-2015** për menaxhim mjedisi ose “**ekuivalente**” objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, të akredituar nga institucione shtetërore vendase ose të huaja e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Çertifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast se OE nuk është prodhues, pranohet dhe një vetdeklarim nga OE ofertues që në këtë rast furnizuesi është conform standarteve (*duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij*).

Argumentim: Bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” neni 79 pika 1 dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) neni 44 pika 1.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Autorizim Prodhuesi** ose **distributori zyrtar** për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme pika 2.3.4 është vendosur sipas nenit 40 pika 3, neni 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në nenin 36 pika 3/b) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi apo të marrë me qera, **një autobus me kapacitet mbajtës mbi 3 ton** për transportin e lëndëve kimike me rrezikshmëri të lartë, drejt vendeve të përcaktuara nga “Shoqëria Rajonale e Ujësjetillës Kanalizime Fier” Sh.a, për të gjithë kohën e ekzekutimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë, mjeti duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

-kur është në pronësi duhet të paraqiten leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë së mjetit dhe çertifikata për transportin e mallrave të rrezikshëm

- kur është me qera kontrata e qerasë e vlefshme për gjithë periudhën e ekzekutimit të kontratës.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku OE vet-deklaron mjetin/et (që disponon për realizimin e kontratës) me targën/at respektive.

Arsyetimi: Bazuar në ligjin nr.118/2012 “Per transportin e mallrave të rrezikshëm” dhe VKM nr.285 dt.19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) neni 40 pika 5, gërma (ç).

➤ SPECIFIKIMET TEKNIKE

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Hipoklorit Natriumi NaClO 13-15% për trajtimin e ujit të pijshëm për konsum human	ton	160
2	Hipoklorit Kalciumi Ca(ClO) ₂ granular për disinfektim ambientesh 60-70%	i ton	1

❖ Hipoklorit Natriumi

Përqindja Hipoklorit natriumi 13-15 %

Malli në momentin e marrjes në dorëzim do të shoqërohet me këto analiza:

1. Analizë plumbi (pb) dhe mërkuri (Hg-hadrargyrum)
2. Analizë e përqindjes së klorit aktiv pranë D.SH.P. Fier

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimit në lidhje me to:

• Hipoklorite Natriumi

-Gjendja e lëngët,ngjyrë e verdhë e çelët me densitet 1.13-1.24

-Të jetë sipas standarteve të përcaktuara me ligj.

-Shkarkimi do të bëhet me autobus për transportin e lëndëve kimike në depozita 2x5 m³ në depot e Koshovicës,vende të tjera shkarkimi do të jenë Kafaraj, Poro. Njësia Administrative Qendër, Libofshë,Mbrostar, Topojë, Dërmenas dhe Fier.

Të gjitha analizat e mësipërme duhet të vërtetojnë se Hipoklorit Natriumi është i përdorshëm për disinfektimin e ujit të destinuar për përdorim human.

Të gjitha analizat e mësipërme duhet të dorëzohen me çdo parti të mallit sipas kërkesave të “Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Fier” Sh.A.

❖ **Hipoklorit Kalciumi**

Përqindja Hipoklorit Kalciumi 60-70 %

Plumbi (Pb) 0.9

Kadmiumi (Cd) 0.27

Kromi (Cr) 1.74

Nikeli (Ni) 1.57

Ngjyra dhe era : ngjyrë e bardhë e hapur në formë granulare.

Të plotësohen kushtet e ruajtjes së lëndëve dizifektante

Transportimi do të bëhet nga vetë furnizuesi

Furnizimi do të bëhet me kërkesë dhe sipas nevojës së AK.

Malli të jetë i paketuar me ambalazhim plastik që të mos ketë kontakt me lagështirën dhe të izohet nga temperaturë, me peshë 20 deri në 50 kg.

Hipoklorit Kalciumi do të përdoret vetëm për dizifektimin e ambjenteve apo vendeve pas përfundimit të punimeve të “Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Fier” Sh.A. Do të përdoret vetëm në ambiente të hapura apo me ajrosje të lartë.

• **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

❖ **GRAFIKU I LËVRIMIT**

Lëvrimi i Hipokloritit të bëhet sipas nevojave të AK, që lidhen me prurjen e ujit, kushtet atmosferike etj.. Mesatarisht 12.5 ton në muaj.

Shënim: këto afate mund të ndryshojnë në varësi të situatave, emergjencave dhe nevojave të punës.

Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____

2. _____

3. _____